

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERJALE PËR MIREMBAJTJEN E STOLAVE DHE KOSHAVE”

MARRËVESHJE KUADËR ME NJË OPERATOR EKONOMIK KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUAR

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 44191300-8; 44531510-9; 44810000-1;

VLERA E FONDIT LIMIT I MARRËVESHJES KUADËR: 8,276,533 (tetë million e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës*

te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të

tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit në një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nëni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nën 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

ISO 9001: - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001, sipas objektit të prokurimit, specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

2.3.3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose te distributorit të autorizuar nga prodhuesi për të gjitha artikujt objekt prokurimi, në rast se nuk është prodhues. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Autoriteti Kontraktor, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues për mallrat që ata ofrojnë. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale për mallra sa më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit sipas specifikimeve teknike. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për artikujt objekt prokurimi është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

Për nga vetë natyra e artikujve objekt prokurimi dhe punonjësit e institucionit që do ti përdorë ato, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmërinë e produkteve të ofruara me standardet e kërkuara në specifikimet teknike të autoritetit kontraktor. Për këtë qëllim, duhet të paraqiten certifikata të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione të pavarura të akredituara, që konfirmojnë përputhshmërinë e modeleve të produkteve me standardet, normat ose referencat e përcaktuara në shtojcën e specifikimeve teknike.

Argumentim : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2028 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Kjo kërkesë synon të garantojë që produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë janë të certifikuara dhe të konformueshme me standardet, normat apo referencat teknike të përcaktuara në shtojcën e specifikimeve teknike. Certifikatat mund të lëshohen nga vetë prodhuesi ose nga institucione të pavarura të akredituara, të cilat veprojnë sipas rregullave ndërkombëtare të vlerësimit të konformitetit.

Ky dokumentacion është thelbësor për të garantuar cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve të furnizuara, si dhe për të mundësuar verifikimin teknik të përputhshmërisë me kërkesat kontraktore, përpara lidhjes së kontratës.. Ky kriter është vendosur, gjithashtu duke iu

referuar specifikimeve teknike ku verifikimi i disa elementeve të cilësisë së artikujve mund të verifikohet vetëm nëpërmjet analizave laboratorike për sa i përket lëndës së pare të përdorur për realizimin e produktit final. Ky kriter ka për qëllim garantimin e konformitetit teknik të produkteve të ofruara, përmes certifikatave të lëshuara nga prodhuesi ose institucione të pavarura të akredituara, që dëshmojnë pajtueshmërinë e produkteve me standardet kombëtare, evropiane apo ndërkombëtare të referuara në dokumentet e tenderit.

Përdorimi i këtyre certifikatave siguron transparencë, kontroll të cilësisë dhe minimizon rrezikun e furnizimit me produkte jo-konforme, duke garantuar se vetëm operatorët ekonomikë që ofrojnë produkte të certifikuara dhe të përputhshme me kërkesat teknike mund të kualifikohen në procedurë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për artikuj që kërkojnë siguri funksionale, qëndrueshmëri dhe përputhje me standardet teknike të detajuara, siç janë produktet për përdorim profesional, industrial apo mbrojtës.

Në këtë mënyrë, certifikatat e përputhshmërisë përfaqësojnë një mjet të domosdoshëm për verifikimin teknik të cilësisë dhe konformitetit të produkteve të ofruara, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike nga prodhuesi ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim: Bazuar në nenin 82 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike janë struktura të specializuara/ Grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik

ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME - T E K N I K E - T E ARGUMENTUARA

1. Bojë për sipërfaqe druri

Karakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:

- Boja duhet të ketë mbulueshmëri shumë të mirë.
- Boja duhet të ofrojë punueshmëri dhe nivelim perfekt.
- Boja duhet të përmbajë aditiv kundër zverdhjes.
- Boja duhet të jetë e pigmentueshme.
- Boja duhet të ofrojë ngjytje shumë të fortë dhe tharje të shpejtë.
- Boja duhet të ofrohet në ngjyra të ndryshme.

Të dhëna teknike të bojës:

- Lloji i rrëshirës: Rrëshirë akrilike
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, **1,20 ± 0,02 gr/ml**
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, **jo më pak se 62%**
- Shkalla e hollimit: **10–20%** (në bazë ujore ose sipas udhëzimeve të prodhuesit)
- Viskoziteti: **115 ± 5 KU** (Krebs Units)
- Shkëlqimi: **90% ± 5% në kënd 60°**
- Koha e tharjes: **jo më shumë se 2–3 orë** në kushte laboratorike (23°C / 50% RH)
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 10 g/l sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent
- VOC – emetimi në ambient: ≥ 0.5 mg/m³ sipas ISO 16000 ose ekuivalent
- Boja duhet të jetë e pajisur me **certifikimin ECOLabel** ose ekuivalent, në përputhje me kërkesat e vendimit të Komisionit sipas standardit 2014/312/UE, për këto parametra:

- Përmbajtje e minimizuar e substancave të rrezikshme

- Përmbajtje e reduktuar e përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC)
- Performancë e mirë për përdorim të brendshëm
- Performancë e mirë për përdorim të jashtëm

Argumentim:

Përzgjedhja e parametrave teknikë të mëposhtëm për bojën për sipërfaqe druri bazohet në kërkesat funksionale të aplikimit profesional të produktit në mjedise të brendshme dhe/ose të jashtme, duke garantuar cilësi të lartë, jetëgjatësi, dhe përputhje me standardet mjedisore dhe të sigurisë:

1. **Rrëshira akrilike** është përzgjedhur si bazë e formulës, pasi ofron qëndrueshmëri ndaj kushteve atmosferike, fleksibilitet në temperaturë, dhe përpunueshmëri të lartë. Ajo është gjithashtu rezistente ndaj zverdhjes dhe e përshtatshme për përdorim në sipërfaqe druri, si në ambiente të brendshme ashtu edhe të jashtme.
2. **Dendësia ($1,20 \pm 0,02$ gr/ml)** sipas **EN ISO 2811-1 ose ekuivalent** tregon cilësinë e dispersionit dhe përqendrimin e përbërësve aktivë. Ky vlerësim është standard për bojëra me performancë të lartë dhe siguron mbulim të mirë pa rritje të tepërt të trashësisë.
3. **Mbetja e thatë ($\geq 62\%$)** sipas **EN ISO 3251 ose ekuivalent** është tregues i përmbajtjes efektive të materialeve mbuluese dhe ndikon drejtpërdrejt në rezistencën e shtresës së bojës. Një përqindje e tillë garanton efikasitet në aplikim dhe redukton nevojën për shtresa shtesë.
4. **Shkalla e hollimit 10–20%** ofron fleksibilitet për aplikim manual ose me pajisje, duke ruajtur një balancë të mirë midis përhapjes dhe ngjitjes. Përqindja është e përshtatshme për të ruajtur viskozitetin optimal.
5. **Viskoziteti 115 ± 5 KU (Krebs Units)** është një parametër i domosdoshëm për të kontrolluar rrjedhshmërinë e bojës dhe aftësinë për të niveluar sipërfaqen, duke siguruar një shtresë të njëtrajtshme pa pika apo shenja të dukshme aplikimi.
6. **Shkëlqimi $90\% \pm 5\%$ në kënd 60°** përbën një standard për bojërat me efekt të lartë reflektimi, të përdorura zakonisht në sipërfaqe dekorative ose mbrojtëse, duke ndihmuar gjithashtu në lehtësinë e pastrimit dhe ruajtjen e estetikës.
7. **Koha e tharjes (jo më shumë se 2–3 orë)** është vendimtare për përshpejtimin e punimeve, reduktimin e ndërprerjeve dhe rritjen e produktivitetit në terren.
8. **VOC ≤ 10 g/l** në përputhje me **Direktivën Evropiane 2004/42/EC dhe emetimi në ambient ≥ 0.5 mg/m³** sipas **ISO 16000** ose ekuivalent, reflektojnë përmbajtjen e ulët të substancave të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin, në përputhje me politikat e BE për ndotjen e brendshme dhe jashtme.
9. **Certifikimi ECOLabel ose ekuivalent** garanton që produkti është prodhuar dhe testuar në përputhje me kriteret strikte të qëndrueshmërisë mjedisore dhe performancës teknike, sipas vendimit të Komisionit 2014/312/UE.
10. **Përcaktimi “ose ekuivalent” për standardet dhe certifikimet** siguron konkurrencë të ndershme midis operatorëve ekonomikë, pa cenuar nivelin minimal të performancës teknike të kërkuar.

2. Primer (astar) për sipërfaqe druri

1. **Karakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:**

- Astari duhet të ofrojë zmerilim të lehtë.
- Astari duhet të ofrojë mbrojtje ndaj korrozionit.
- Astari duhet të ketë mbulueshmëri të shkëlqyer.
- Astari duhet të ofrojë veti shumë të mira mbushjeje.
- Astari duhet të sigurojë punueshmëri dhe nivelim perfekt.
- Astari duhet të ketë ngjitje të fortë dhe tharje të shpejtë.

2. **Të dhëna teknike të astarit:**

- Lloji i rrëshirës: Rrëshirë alkide
- Dendësia: sipas standardit **EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, $1,45 \pm 0,02$ gr/ml**
- Mbetja e thatë: sipas standardit **EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 55%**
- Shkalla e hollimit: **10–20%**, sipas udhëzimeve të prodhuesit
- Viskoziteti: **115 ± 5 KU (Krebs Units)**
- Koha e tharjes: **jo më shumë se 2–4 orë**, në kushte standarde laboratorike (23°C / 50% RH)
- Koha për rilyerje: **jo më shumë se 6–8 orë**
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 100 g/l, sipas **Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent**
- TVOC – emetimi në ambient: ≥ 20 mg/m³, sipas **ISO 16000 ose ekuivalent**

Argumentim

Zgjedhja e këtyre parametrave për astarin mbështetet në funksionin bazë të produktit si shtresë përgatitore për bojë, e cila duhet të sigurojë ngjitje maksimale, mbushje uniforme të poreve të drurit dhe mbrojtje kundër agjentëve të jashtëm si lagështia dhe korrozioni:

1. **Rrëshira alkide** është përzgjedhur për vetitë e saj të mira penetruese dhe ngjitëse mbi sipërfaqet druri, si dhe për rezistencën që ofron ndaj përkeqësimit nga faktorët atmosferikë dhe kimikë.
2. **Dendësia $1,45 \pm 0,02$ gr/ml** sipas **EN ISO 2811-1 ose ekuivalent** siguron një balancë optimale midis përbërësve të ngurtë dhe tretësit, duke lejuar mbulim të njëtrajtshëm dhe trajtim të mirë sipërfaqësor.
3. **Mbetja e thatë $\geq 55\%$** tregon përqindjen efektive të substancave mbuluese, duke përmirësuar ndjeshëm përgatitjen e sipërfaqes për shtresën përfundimtare të bojës.
4. **Viskoziteti 115 ± 5 KU** garanton rrjedhshmëri të kontrolluar dhe aplikim të njëtrajtshëm, veçanërisht me furçë apo rrotullim.
5. **VOC ≤ 100 g/l dhe TVOC ≥ 20 mg/m³**, sipas standardeve mjedisore të BE, sigurojnë përputhje me kërkesat për emetim të reduktuar të përbërjeve të rrezikshme në mjedis, veçanërisht në ambientet e brendshme.
6. **Përdorimi i termit “ose ekuivalent” për standardet dhe direktivat**, është i domosdoshëm për të ruajtur konkurrencën e drejtë mes operatorëve ekonomikë, duke mos devijuar nga cilësia e kërkuar.

3. **Llak transparent për dru me filtra UV**

Karakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:

- Llaku duhet të jetë i punueshëm dhe të sigurojë nivelim shumë të mirë.
- Llaku duhet të mbrojë dhe të rrisë bukurinë natyrore të drurit.
- Llaku duhet të ketë ngjitje shumë të fortë dhe tharje të shpejtë.

- Llaki duhet të sigurojë një sipërfaqe elastike, të fortë dhe shumë të qëndrueshme ndaj kushteve të pafavorshme atmosferike.
- Llaki duhet të përmbajë filtra UV për mbrojtje nga efektet dëmtuese të dritës së diellit.

Të dhëna teknike të llakut:

- Lloji i rrëshirës: Rrëshirë akrilike
- Dendësia: sipas standardit **EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, $1,20 \pm 0,02$ gr/ml**
- Mbetja e thatë: sipas standardit **EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 35%**
- Shkalla e hollimit: **10–20%**, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit
- Viskoziteti: **45 ± 5 KU (Krebs Units)**
- Koha e tharjes: **jo më shumë se 2–3 orë**, në kushte standarde (23°C / 50% RH)
- VOC në produktin e gatshëm: **≤ 10 g/l**, sipas **Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent**
- VOC – emetimi në ambient: **≤ 0.2 mg/m³**, sipas **ISO 16000 ose ekuivalent**

Argumentim Teknik

Përzgjedhja e specifikimeve për llakun transparent mbi bazë akrilike për dru është bërë për të garantuar **funksionalitet të lartë mbrojtës dhe estetik**, veçanërisht në ambiente të ekspozuara ndaj diellit, lagështirës apo kushteve të tjera atmosferike.

1. **Rrëshira akrilike** siguron një film fleksibël, elastik dhe rezistent ndaj çarjes ose zbardhjes. Ajo është shumë e qëndrueshme ndaj ekspozimit UV dhe nuk zverdhet me kalimin e kohës.
2. **Dendësia $1,20 \pm 0,02$ gr/ml dhe mbetja e thatë $\geq 35\%$** , sipas **standardeve EN ISO ose ekuivalente**, tregojnë përqendrimin e materialit aktiv në produkt dhe garantojnë formimin e një shtrese mbrojtëse të dukshme, pa ngarkesë të tepërt të sipërfaqes.
3. **Viskoziteti 45 ± 5 KU** është i përshtatshëm për aplikim të lehtë me furçë, rotullim ose spërkatje, pa rrjedhje apo pika.
4. **Koha e tharjes ≤ 3 orë** e bën produktin të përshtatshëm për cikle pune të shpejta dhe aplikime industriale ose artizanale.
5. **Përmbajtja shumë e ulët e VOC (≤ 10 g/l) dhe emetimi në ambient ≤ 0.2 mg/m³**, e certifikon produktin si të sigurt për përdorim në ambiente të brendshme, në përputhje me legjislacionin mjedisor evropian.
6. **Filtrat UV të integruar** në përbërje janë thelbësorë për mbrojtjen afatgjatë të drurit ndaj zbardhjes dhe prishjes kimike nga rrezatimi diellor – një veçori që e bën produktin të domosdoshëm për ambiente të jashtme.
7. **Përdorimi i termit “ose ekuivalent”** për standardet dhe direktivat garanton konkurrencë të barabartë pa ulur nivelin minimal teknik të kërkuar.

4. Bojë për sipërfaqe metalike

Karakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:

- Boja duhet të ketë mbulueshmëri shumë të mirë.
- Boja duhet të ofrojë punueshmëri dhe nivelim perfekt.
- Boja duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj goditjeve.
- Boja nuk duhet të përmbajë komponime të kromit dhe të plumbit.

- Boja duhet të ofrojë ngjitje shumë të fortë dhe tharje të shpejtë.
- Boja duhet të ofrohet në ngjyra të ndryshme.

Të dhëna teknike të bojës:

- Lloji i rrëshirës: Rrëshirë akrilike
- Dendësia: sipas standardit **EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, $1,20 \pm 0,01$ kg/l**
- Mbetja e thatë: sipas standardit **EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 72%**
- Shkalla e hollimit: **10–20%**, sipas udhëzimeve të prodhuesit
- Shkalla e hapjes: **≥ 10 m²/litër**, në sipërfaqe të lëmuara
- Viskoziteti: **95 ± 5 KU (Krebs Units)**
- Koha e tharjes: **jo më shumë se 4 orë**, në kushte standarde (23°C / 50% RH)
- Aftësia mbuluese: **$\geq 99,5\%$ – Klasa I**, sipas **EN ISO 6504-3 ose ekuivalent**
- Klasa e rezistencës ndaj larjes: **Klasa I**, sipas **ISO 11998 ose ekuivalent**
- VOC në produktin e gatshëm: **≤ 100 g/l**, sipas **Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent**
- TVOC – emetimi në ambient: **≥ 20 mg/m³**, sipas **ISO 16000-9 ose ekuivalent**

Argumentim Teknik :

Përcaktimi i këtyre specifikimeve synon garantimin e një performance të lartë për mbrojtjen dhe dekorimin e sipërfaqeve metalike, në përputhje me kërkesat funksionale, ambientale dhe të sigurisë:

1. **Rrëshira akrilike** është përzgjedhur për rezistencën ndaj kushteve të jashtme dhe qëndrueshmërinë e ngjyrës, si dhe për formimin e një shtrese të fortë dhe elastike që nuk çahet lehtësisht në sipërfaqe metalike.
2. **Dendësia $1,20 \pm 0,01$ kg/l dhe mbetja e thatë $\geq 72\%$** , sipas **EN ISO 2811-1 dhe EN ISO 3251 ose ekuivalent**, tregojnë përqindje të lartë të materialit të ngurtë në produkt, duke rritur efikasitetin mbulues dhe jetëgjatësinë.
3. **Viskoziteti 95 ± 5 KU** është optimal për aplikim të kontrolluar dhe pa pikatje, veçanërisht në aplikime me spërkatje ose rul.
4. **Shkalla e hapjes ≥ 10 m²/litër** përputhet me efikasitetin ekonomik të produktit dhe shmang nevojën për shtresa të shumta.
5. **Rezistenca ndaj larjes (ISO 11998 – Klasa I)** dhe **aftësia mbuluese (ISO 6504-3 – Klasa I)** janë tregues të një boje cilësore për përdorim industrial dhe ekspozim të shpeshtë ndaj agjentëve pastrues ose gërryes.
6. **Përjashtimi i komponimeve të kromit dhe plumbit** është në përputhje me legjislacionin evropian REACH dhe praktikën e qëndrueshme të prodhimit.
7. **VOC ≤ 100 g/l dhe TVOC ≥ 20 mg/m³**, sipas **direktivës 2004/42/EC dhe ISO 16000-9 ose ekuivalent**, sigurojnë mbrojtje mjedisore dhe shëndetësore në përdorim të përditshëm apo industrial.
8. **Përdorimi i termit “ose ekuivalent”** në çdo standard e bën dokumentin të hapur për produkte që ofrojnë performancë të barabartë, duke ruajtur konkurrencën pa devijuar nga kërkesat teknike.
9. **arakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:**
 - Solucioni duhet të jetë i përshtatshëm për dysheme dhe sipërfaqe të jashtme.
 - Përbërja kimike kryesore: **Propionat dedikil metilpoli(oksietil)amoniumi**.
 - Produkti duhet të ketë **veprim të certifikuar kundër myqeve dhe baktereve**.
 - Produkti duhet të jetë **i tretshëm në bazë ujore**.
 - Produkti duhet të jetë **hiperkoncentrat**, i cili vepron duke u holluar në përqindjet e

rekomanduara, duke realizuar efekt të lartë pastrues në kohë të shkurtër veprimi.
– Si përbërës shtesë, produkti duhet të përmbajë: **acid edetik, hidroksid kaliumi dhe acid propionik.**

- Të jetë **i prodhuar në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1272/2008 dhe ndryshimet e saj**, për kategorizimin e rreziqeve gjatë përdorimit.
- Përzierja nuk duhet të përmbajë substanca të klasifikuara si “**Substanca me Shqetësim Shumë të Lartë**” (SVHC) $\geq 0.1\%$, të publikuara nga **Agjencia Evropiane e Kimikateve (ECHA)** sipas nenit 57 të **REACH**.

5. Primer (astar) antiruxho për sipërfaqe metalike

Karakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:

- Astari duhet të ofrojë zmerilim të lehtë.
- Astari duhet të ofrojë mbrojtje ndaj korrozionit.
- Astari duhet të ketë mbulueshmëri të shkëlqyer.
- Astari duhet të ofrojë veti shumë të mira mbushjeje.
- Astari duhet të sigurojë punueshmëri dhe nivelim perfekt.
- Astari duhet të ketë ngjitje të fortë dhe tharje të shpejtë.
- Astari duhet të ofrohet në ngjyra të ndryshme.

Të dhëna teknike të astarit:

- Lloji i rrëshirës: Rrëshirë alkide
- Dendësia: sipas standardit **EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, $1,45 \pm 0,02$ gr/ml**
- Mbetja e thatë: sipas standardit **EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 75%**
- Shkalla e hollimit: **10–20%**, sipas udhëzimeve të prodhuesit
- Viskoziteti: **115 ± 5 KU (Krebs Units)**
- Koha e tharjes: **jo më shumë se 2–4 orë**, në kushte standarde (23°C / 50% RH)
- Koha për rilyerje: **jo më shumë se 6–8 orë**
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 100 g/l, sipas **Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent**
- TVOC – emetimi në ambient: ≥ 20 mg/m³, sipas **ISO 16000-9 ose ekuivalent**

Argumentim Teknik:

Ky produkt është projektuar për përdorim mbi metale të ekspozuara ndaj rrezikut të korrozionit, duke garantuar funksion mbrojtës dhe përgatitës optimal për aplikimin e mëtejshëm të bojës përfundimtare:

1. **Rrëshira alkide** është e njohur për aftësinë e saj të shkëlqyer për të ngjitur në metale dhe për të formuar një film të fortë që reziston ndaj lagështisë dhe oksigjenit – dy faktorë kryesorë të korrozionit.
2. **Dendësia ($1,45 \pm 0,02$ gr/ml) dhe mbetja e thatë ($\geq 75\%$),** sipas standardeve **EN ISO ose ekuivalente**, janë parametra që garantojnë përqendrim të lartë të substancave aktive dhe krijimin e një shtrese uniforme dhe efektive antikorrozive.
3. **Shkalla e hollimit 10–20%** ofron fleksibilitet në aplikim sipas kushteve teknike dhe mjetit të përdorur (spërkatje, rul, furçë), pa ndikuar në performancën e produktit.
4. **Koha e tharjes ≤ 4 orë dhe koha për rilyerje ≤ 8 orë** janë në përputhje me ciklet standarde të punimeve industriale ose artizanale, duke lehtësuar vazhdimësinë e proceseve.

5. **Viskoziteti 115 ± 5 KU** siguron një shpërndarje optimale të astarit në sipërfaqe dhe ndihmon në mbushjen e poreve apo defekteve të lehta.
6. **Përputhshmëria me direktivën 2004/42/EC dhe standardin ISO 16000-9** siguron që produkti respekton kufizimet për emetimin e përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC), duke qenë i përshtatshëm edhe për mjedise të brendshme ose të gjysmë-mbyllura.
7. **Përdorimi i termit “ose ekuivalent”** në referencat standarde është i domosdoshëm për të garantuar pjesëmarrje të drejtë në prokurim dhe një treg të hapur me alternativa cilësore të barasvlershme.

6. Pastrues për sipërfaqe të jashtme metalike dhe drusore

Karakteristikat e përgjithshme të produktit duhet të jenë:

- Solucioni duhet të jetë i përshtatshëm për dysheme dhe sipërfaqe të jashtme.
- Përbërja kimike kryesore: **Propionat dedikil metilpoli(oksietil)amoniumi**.
- Produkti duhet të ketë **veprim të certifikuar kundër myqeve dhe baktereve**.
- Produkti duhet të jetë **i tretshëm në bazë ujore**.
- Produkti duhet të jetë **hiperkoncentrat**, i cili vepron duke u holluar në përqindjet e rekomanduara, duke realizuar efekt të lartë pastrues në kohë të shkurtër veprimi.
- Si përbërës shtesë, produkti duhet të përmbajë: **acid edetik, hidroksid kaliumi dhe acid propionik**.
- Të jetë **i prodhuar në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1272/2008 dhe ndryshimet e saj**, për kategorizimin e rreziqeve gjatë përdorimit.
- Përzierja nuk duhet të përmbajë substanca të klasifikuara si **“Substanca me Shqetësim Shumë të Lartë” (SVHC) $\geq 0.1\%$** , të publikuara nga **Agjencia Evropiane e Kimikateve (ECHA)** sipas nenit 57 të **REACH**.

Veprimtaria	Standarti i aplikuar ose ekuivalent	Ngarkesa mikrobike	Përqendrimi	Koha e veprimit
Baktericide	EN 13727	Stafilokoku aureus, Pseudomonas aeruginosa, Enterococcus hirae	$\geq 0,25\%$	jo me shume se 5 min.
	EN 16615		$\geq 0,25\%$	jo me shume se 15 min.
	EN 1276	Stafilokoku aureus, Pseudomonas aeruginosa, Enterococcus hirae, E. coli	≥ 0.01	jo me shume se 5 min.
	EN 13697		≥ 0.01	jo me shume se 5 min.
	EN 13727	Enterokokus faecium ERV	$\geq 0,25\%$	jo me shume se 5 min.
Jeasticidal	EN 13624	Kandida albicans	0,25%	jo me shume se 5 min.
	EN 16615		0,25%	jo me shume se 15 min.
	EN 1650		0,5%	jo me shume se 5 min.
	EN 13697		1%	jo me shume se 5 min.
	EN 13624	Kandida Auris	0,25%	jo me shume se 5 min.
Kërpudhave	EN 13697	Aspergillus Braziliensis	2%	jo me shume se 10 min.

	EN 1650		2%	jo me shume se 15 min.
Virusidal kundër viruset me mbështjellës	EN 14476	Virusi i Vaccinias	0,25% 0,5%	jo me shume se 10 min. jo me shume se 5 min.
Aktiv ndaj Rotavirusit	EN 14476	Rotavirusi	0,25% 0,5%	jo me shume se 10 min. jo me shume se 5 min.
Aktiv në PRV	EN 14476	PRV (Modeli i virusit të hepatitit B)	0,25%	jo me shume se 1 min.
Aktiv ndaj HIV-it	EN 14476	HIV-it	0,25%	jo me shume se 15 min.
Sporicide kundër Klostridiumit	EN 13704	Klostridium difficile	1%	jo me shume se 15 min.
	EN 17126			

Argumentim Teknik:

1. **Fokusi në pastrim të thelluar dhe dezinfektim të shpejtë** në sipërfaqe të jashtme (dru & metal) kërkon produkte me formulë të përqendruar dhe të tretshme në ujë, që garantojnë efikasitet të lartë në kohë të shkurtër dhe konsum të reduktuar sasior.
2. **Propionati i dedikil metilpoli(oksietil)amoniumit**, në kombinim me **acidin edetik, acidin propionik dhe hidroksidin e kaliumit**, përbën një strukturë kimike shumë të qëndrueshme dhe efektive si baktericid, fungicid dhe virucid, veçanërisht ndaj biofilmeve dhe ndotjeve organike në sipërfaqe të hapura.
3. **Përputhja me Rregulloren 1272/2008 (CLP)** dhe eliminimi i substancave SVHC $\geq$ 0.1% sipas REACH garantojnë përputhje të produktit me direktivat më të fundit të BE-së mbi përdorimin e substancave kimike të rrezikshme.
4. **Testimi sipas një sërë standardesh EN (13727, 1276, 13697, 14476, 13704 etj.) ose ekuivalente**, është i domosdoshëm për të siguruar që efekti antibakterial, antifungik, virucid dhe sporicid i produktit është i certifikuar dhe i zbatueshëm në praktika profesionale pastrimi.
5. **Përdorimi i formulës “ose ekuivalent”** në të gjitha standardet e aplikuara e bën dokumentin të pranueshëm për një gamë më të gjerë produktesh me veti të barasvlershme, duke ruajtur cilësinë e kërkuar dhe duke promovuar konkurrencën reale.

7. Letër zmerilimi për pastrimin e bojës së vjetër (për sipërfaqe druri)

Specifikime teknike të produktit:

- **Përdorimi:** Letra duhet të jetë e përshtatshme për zmerilimin e sipërfaqeve druri, me qëllim largimin e bojës së vjetër dhe papastërtive, duke lënë një sipërfaqe të pastër dhe të gatshme për trajtim të mëtejshëm.
- **Materiali aktiv:** Oksid alumini ose ekuivalent, me qëndrueshmëri të lartë dhe performancë abrasive të qëndrueshme.

- **Mbështetës (substrat):** Letër e tipit industrial me rezistencë ndaj grisjes.
- **Mënyra e kapjes së letrës:** Universale/standard, e përshtatshme për makina elektrike zmeriluese të brezit.
- **Përmasat:** Gjerësi 100 mm × Gjatësi 610 mm
- **Gradimi i ashpërsisë (grit):** P110, sipas standardit **FEPA (Federation of European Producers of Abrasives)** ose ekuivalent

Argumentim Teknik:

Përdorimi i letrës zmeriluese në procesin e përgatitjes së sipërfaqeve druri është një hap i domosdoshëm për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e aplikimeve të mëvonshme, si astarët apo shtresat përfundimtare të bojës apo llakut. Për këtë qëllim, janë përcaktuar specifikime teknike që balancojnë **efikasitetin abrasiv, përdorshmërinë mekanike dhe përputhshmërinë me pajisjet elektrike të zakonshme të tregut.**

1. **Materiali aktiv – oksid alumini ose ekuivalent** është përzgjedhur për shkak të qëndrueshmërisë së tij të lartë ndaj konsumit dhe efikasitetit në largimin e bojës së vjetër dhe papastërtive pa dëmtuar strukturën e drurit. Ky material është gjithashtu më pak agresiv se karbiti i siliciumit, duke e bërë të përshtatshëm për aplikime mbi sipërfaqe të buta dhe të mesme.
2. **Gradimi P110**, sipas standardit **FEPA ose ekuivalent**, është kategorizuar si një grit **mesatar-fin**, ideal për pastrim të bojës pa gërryerje të thellë të sipërfaqes. Kjo shkallë ashpërsie ofron një balancë optimale midis agresivitetit abrasiv dhe mbrojtjes së fibrave të drurit.
3. **Mbështetësi industrial** (substrati) siguron rezistencë ndaj grisjes gjatë përdorimit në makineri me rrotullim të vazhdueshëm, duke përmirësuar jetëgjatësinë e letrës zmeriluese dhe duke reduktuar ndërprerjet në procesin e punës.
4. **Mënyra standarde e kapjes** e bën këtë produkt të përshtatshëm për përdorim universal në makinat zmeriluese të brezit, çka përmirëson efikasitetin operativ dhe shmang kufizimet teknike të operatorit.
5. **Përmasat 100 mm × 610 mm** përputhen me pajisjet më të zakonshme të zmerilimit të brezit dhe lejojnë mbulim të mirë të sipërfaqes me pak kalime, duke rritur produktivitetin dhe reduktuar humbjet materiale.
6. **Përdorimi i formulës “ose ekuivalent” për gradimin dhe materialet** garanton konkurrencë të ndershme mes operatorëve ekonomikë, pa devijuar nga cilësia teknike minimale e kërkuar për funksionin specifik.

8. Letër zmerilimi për pastrimin e sipërfaqeve të koroduara (për sipërfaqe metalike)

Specifikime teknike të produktit:

- **Përdorimi:** Letra duhet të jetë e përshtatshme për zmerilimin e sipërfaqeve metalike të koroduara, me qëllim pastrimin nga ndryshku, pluhuri dhe shtresat e degraduara të bojës, pa dëmtuar sipërfaqen.
- **Materiali aktiv:** Karabitilici ose oksid alumini (ose ekuivalent), i përshtatshëm për përdorim në metale.
- **Mbështetës (substrat):** Letër e fortë me rezistencë ndaj konsumit të lartë dhe grisjes.

- Mënyra e kapjes së letrës: Universale/standard, e përputhshme me makinat zmeriluese me brez.
- Përmasat: Gjerësi 100 mm × Gjatësi 610 mm
- Gradimi i ashpërsisë (grit): P80, sipas standardit FEPA ose ekuivalent

Argumentim Teknik:

Ky produkt është projektuar për zmerilim mekanik të sipërfaqeve metalike që kanë shfaqur korrozion ose përmbajnë bojë të degraduar, duke ndihmuar në përgatitjen optimale të sipërfaqes për aplikimin e astarëve antikorrozivë ose shtresave përfundimtare të mbrojtjes.

1. **Materiali abrasiv – karabit i siliciumit ose oksid alumini**, është përzgjedhur për **fortësinë dhe efektin prerës** të tij në sipërfaqe të forta si metali. Ai lejon heqjen efektive të ndryshkut dhe shtresave të ngjitura të bojës pa dëmtuar strukturën bazë të materialit.
2. **Gradimi P80**, sipas **standardit FEPA ose ekuivalent**, është klasifikuar si **ashpërsi e mesme**, që balancohet mirë ndërmjet gërryerjes efektive dhe shmangies së gërryerjeve të thella. Është ideal për pastrim të fazës së parë në sipërfaqe metalike me dëmtime ose korrozion të lehtë/mesatar.
3. **Mbështetësi i fortë industrial** siguron që letra të mos çahet apo dëmtohet gjatë përdorimit me makina elektrike, veçanërisht kur përballon forca më të mëdha presioni dhe nxehtësie gjatë punës.
4. **Përmasat standarde (100 × 610 mm)** e bëjnë produktin të përputhshëm me pajisjet zmeriluese më të përdorura në sektorin e ndërtimit dhe përpunimit industrial, duke siguruar mbulim optimal dhe efikasitet në punë.
5. **Përdorimi i formulimit “ose ekuivalent” për standardin FEPA** siguron fleksibilitet në ofertim dhe pjesëmarrje më të gjerë në procedura prokurimi, duke ruajtur nivelin teknik të kërkuar për cilësi dhe performancë.

9. Pajisje pune për montim–çmontim (mjet elektrik me akumulator)

Specifikime teknike të produktit:

- Tensioni i akumulatorit: Jo më pak se 18 V (teknologji LXT ose ekuivalente)
- Kapaciteti i akumulatorit: Të përfshihen të paktën 2 copë bateri Li-ion, secila me kapacitet jo më pak se 3.0 Ah
- Lloji i akumulatorit: Li-ion
- Numri i rrotullimeve/minutë në fazën I: 0–500 rpm
- Numri i rrotullimeve/minutë në fazën II: 0–1900 rpm
- Kapaciteti i mandrinës: 1.5 – 13 mm
- Kapaciteti maksimal në përdorim mbi çelik: Jo më pak se 13 mm
- Kapaciteti maksimal në përdorim mbi dru: Jo më pak se 38 mm
- Forca maksimale në modalitetin e parë: ≥ 50 Nm
- Forca maksimale në modalitetin e dytë: ≥ 27 Nm
- Presioni i tingullit (zhurma): 77 dB(A)
- Pasiguria e zhurmës: ± 3.0 dB(A)
- Dridhjet në shpim metalik: 2.5 m/s²
- Pasiguria K (vibrim): ± 1.5 m/s²
- Përmasat e pajisjes (gjatësia x gjerësia x lartësia): 168–170 mm × 78–79 mm × 250–255 mm

- Pesha: $1.7 \text{ kg} \pm 0.1 \text{ kg}$
- Paketimi: Valixhe plastike e tipit MakPac ose ekuivalente

Argumentim Teknik:

Ky mjet është projektuar për punime të vazhdueshme mekanike në mjedise të ndryshme pune (ndërtim, mirëmbajtje, përpunim teknik), ku kërkohen **fuqi, autonomi, peshë e lehtë dhe performancë e qëndrueshme**.

1. **Tensioni 18 V dhe kapaciteti $\geq 3.0 \text{ Ah}$ me 2 bateri** sigurojnë një cikël pune të gjatë dhe të pandërprerë. Teknologjia **Li-ion** ofron peshë më të lehtë dhe jetëgjatësi më të madhe, duke qenë më e avancuar se teknologjitë e mëparshme (Ni-Cd, NiMH).
2. **Dy nivelet e shpejtësisë (0–500 rpm dhe 0–1900 rpm)** ofrojnë fleksibilitet për aplikime të ndryshme:
 - shpejtësi e ulët për fuqizim dhe mbyllje të bulonave,
 - shpejtësi e lartë për shpim në materiale të ndryshme.
3. **Kapacitetet e shpimit (13 mm në çelik dhe 38 mm në dru)** e bëjnë të përshtatshëm për punime ndërtimi apo mekanike me përmasa të mesme dhe të mëdha.
4. **Forca rrotulluese $\geq 50 \text{ Nm}$ / $\geq 27 \text{ Nm}$** në dy modalitete, i siguron përdoruesit kontroll dhe fuqi të mjaftueshme për punë të rënduara, duke mbrojtur gjithashtu mekanizmin nga dëmtimi.
5. **Zhurma dhe vibrimet e kontrolluara ($\leq 77 \text{ dB}$ dhe $\leq 2.5 \text{ m/s}^2$)** janë brenda kufijve të lejuar për përdorim të sigurt dhe komod në mjedise pune të zgjatura.
6. **Dimensionet e balancuara dhe pesha e lehtë ($1.7 \text{ kg} \pm 0.1$)** përmirësojnë manovrueshmërinë dhe reduktojnë lodhjen gjatë përdorimit.
7. **Valixhja plastike tip MakPac ose ekuivalente** është standard i industrisë për transport të sigurt dhe organizim të pajisjes me aksesoret përkatës.

10. Elemente për montimin e ristelave (bullona 6 cm + dado + rondela)

Specifikime teknike të produktit:

- **Përdorimi:** Elementet duhet të jenë të përshtatshme për punime në strukturë druri, duke garantuar montim të qëndrueshëm, forcë mekanike të lartë dhe stabilitet të vazhdueshëm të konstruksionit.
- **Përbërja e setit:** Çdo njësi montimi duhet të përbëhet nga:
 - Bullon çeliku me gjatësi 60 mm
 - Dado (vidë mbyllëse) përkatëse
 - Rondela metalike (minimumi një për njësi)
- **Materiali:** Çelik i galvanizuar ose trajtim tjetër antikoroziv, i përshtatshëm për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm.
- **Përmasat e bullonit dhe filetimit:** M6 (diametër nominal 6 mm)
- **Standardi i prodhimit:** DIN 5587 ose ekuivalent

Argumentim Teknik:

1. **Përdorimi i elementeve të dimensionit M6 dhe gjatësi 60 mm** është optimal për ndërlidhjen e ristelave me trarë ose struktura druri, duke siguruar ngulitje të thellë dhe fiksion të qëndrueshëm pa rrezik çarjeje të drurit.

2. **Çeliku i galvanizuar** ofron rezistencë ndaj korrozionit, veçanërisht në mjedise të lagështa ose të jashtme, duke garantuar jetëgjatësi të sistemit të montimit.
3. **Përfshirja e dado-s dhe rondelës** është thelbësore për shpërndarjen e njëtrajtshme të ngarkesës dhe për të parandaluar dëmtimin e sipërfaqes së drurit gjatë shtrëngimit.
4. **Standardi DIN 5587 ose ekuivalent** garanton përmasa të sakta dhe përputhshmëri me vegla standarde pune. Përfshirja e termit “ose ekuivalent” mundëson përdorimin e produkteve të tjera me përputhje dimensionale dhe mekanike, sipas katalogëve industrialë të homologuar.

11. Element për inkastrim dhe montimin e elementeve dekorative (vida 6–7 cm + rondela + upa)

Specifikime teknike të produktit

Vida për dru:

- Vida duhet të jetë e përshtatshme për montim në materiale druri me densitet të lartë, duke përfshirë struktura të forta si trarë, panelet e ngjeshura ose bordet teknike.
- Vida duhet të ketë **filetim të posaçëm për fiksime në dru**, që mundëson hyrje graduale dhe kapje të qëndrueshme pa deformuar materialin.
- Materiali: **Çelik i galvanizuar ose inox**, me **rezistencë ndaj korrozionit** për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- **Përmasat e vidës:** $3.9 \times 35 \text{ mm} \pm 5 \text{ mm}$ (gjatësia në varësi të trashësisë së materialit)

Upa për dru (fisha plastike zgjeruese):

- Upat duhet të jenë të përshtatshme për përdorim në materiale druri dhe për struktura ku kërkohet fiksime të qëndrueshme të elementeve dekorative ose funksionale.
- Duhet të ofrojnë **kapje të sigurt dhe pa rrëshqitje**, edhe në materiale me strukturë të thërrmuar ose me densitet mesatar.
- **Materiali:** Najlon ose plastikë me rezistencë të lartë mekanike dhe ndaj temperaturave.
- **Përmasat e upave:** 6 mm, 7 mm, 8 mm, 10 mm, 12 mm

Rondela (nëse kërkohet):

- Prej çeliku të galvanizuar, të përshtatshme për shpërndarjen e ngarkesës në sipërfaqe druri dhe mbrojtjen nga dëmtimi gjatë shtrëngimit.

Argumentim Teknik:

Vida me fileto për dru janë të domosdoshme për montime precize dhe të qëndrueshme në panele, mbështetëse, ose konstruksione prej druri. Filetimi specifik e dallon nga vida universale apo metalike, duke garantuar mbajtje më të fortë dhe shmangie të çarjeve në strukturën e drurit.

1. **Materiali rezistent ndaj korrozionit (çelik i galvanizuar)** lejon përdorim të sigurt edhe në ambiente me lagështi apo ndryshime temperaturash, duke shmangur oksidimin e vidave në kohë.
2. **Përmasat $3.9 \times 35 \text{ mm} \pm 5 \text{ mm}$** janë të përshtatshme për shumicën e elementeve dekorative të montimit në sipërfaqe druri, duke ofruar fleksibilitet në bazë të trashësisë së strukturës.

3. **Upat plastike të dimensioneve 6–12 mm** mundësojnë zgjedhje të saktë në varësi të hapjeve, gjerësisë së vrimës paraprahe dhe madhësisë së ngarkesës që pritet të përballojnë. Lëndët plastike të cilësisë së lartë si najloni sigurojnë ekspansion të mirë dhe jetëgjatësi në përdorim.
4. **Përfshirja e rondelës (ku nevojitet)** shton vlerë funksionale, duke shpërndarë forcat e shtrëngimit në mënyrë uniforme dhe duke mbrojtur sipërfaqet dekorative nga shtypja apo dëmtimi.
5. **Përdorimi i termave “ose ekuivalent” dhe tolerancës dimensionale ± 5 mm** është në përputhje me praktikën e furnizimit publik, duke garantuar pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve pa ulur cilësinë e kërkuar teknike.

12. Gozhda për dru

Specifikime teknike të produktit:

- **Përdorimi:** Gozhdët duhet të jenë të përshtatshme për **fiksimin e objekteve të ndryshme prej druri**, përfshirë kompensatë druri, ristela, mbështetëse dekorative, etj.
- **Materiali:** **Çelik i galvanizuar ose ekuivalent**, me rezistencë ndaj korrozionit për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- **Struktura:** Trup cilindrik me majë të mprehtë për futje të lehtë dhe kokë të sheshtë ose ovale për fiksime të mirë mekanike pa dëmtim të sipërfaqes.
- **Përmasat:** 3.8×50 mm, me tolerancë të pranueshme ± 1 mm

Argumentim Teknik:

1. **Gozhdët 3.8×50 mm** përfaqësojnë një dimension të zakonshëm dhe të përshtatshëm për fiksime në pjesë druri të dendësive të ndryshme, duke ofruar **mbajtje të mjaftueshme pa rrezikuar çarje të materialit**, sidomos në kompensata dhe ristela me trashësi të mesme.
2. **Materiali çelik i galvanizuar** është përzgjedhur për shkak të **rezistencës ndaj oksidimit**, veçanërisht në mjedise ku gozhdët janë të ekspozuara ndaj lagështirës ose ndryshimeve të temperaturës. Në rastet kur kërkohet përdorim në ambiente shumë agresive, mund të pranohet edhe çelik inox ose trajtime antikorrozive ekuivalente.
3. **Struktura e thjeshtë me majë të mprehtë dhe trup të drejtë** siguron futje të drejtë dhe fiksime të qëndrueshme, duke e bërë këtë produkt të përshtatshëm për përdorim të gjerë në ndërtim të lehtë ose mobilim të përkohshëm/mesatar.
4. **Përdorimi i një margjine tolerimi ± 1 mm** për gjatësi dhe trashësi siguron fleksibilitet për furnizuesit, pa ndikuar në funksionalitetin teknik të kërkuar për aplikimin.

13. Ristela druri – Tipologjia 1

Specifikime teknike të produktit:

- **Lloji i drurit:** Dru pishe (Pinus spp.)
- **Përmasat e ristelës:** Gjatësia: 127 cm; Gjerësia: 6 cm; Trashësia: 3 cm
- **Cilësia e drurit:** Cilësi e parë (klasa më e lartë), pa defekte strukturore apo vizuale
- **Rezistenca:** Të jetë shumë rezistente ndaj faktorëve të jashtëm: **lagështisë, rrezatimit UV, temperaturave ekstreme dhe borës**

14. Ristela druri – Tipologjia 2

Specifikime teknike të produktit:

- **Lloji i drurit:** Dru pishe (Pinus spp.)
- **Përmasat e ristelës:** Gjatësia: 150 cm; Gjerësia: 6 cm; Trashësia: 3 cm
- **Cilësia e drurit:** Cilësi e parë, me trajtim sipërfaqësor për mbrojtje ndaj agjentëve atmosferikë
- **Rezistenca:** Të jetë shumë rezistente ndaj faktorëve të jashtëm: **ujit, diellit, borës**

15. Ristela druri – Tipologjia 3

Specifikime teknike të produktit:

- **Lloji i drurit:** Dru pishe (Pinus spp.)
- **Përmasat e ristelës:** Gjatësia: 400 cm; Gjerësia: 6 cm; Trashësia: 3 cm
- **Cilësia e drurit:** Cilësi e parë, pa nyje të hapura, deformime apo çarje
- **Rezistenca:** Të jetë shumë rezistente ndaj ndikimeve të jashtme (lagështirë, rrezatim diellor, ngrica)

Argumentim Teknik për Ristelet e Drurit (Tipologjitë 1–3)

1. **Druri i pishës (Pinus spp.)** është i përzgjedhur për vetitë e tij fiziko-mekanike të favorshme për përdorim në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Ka dendësi mesatare, përthith mirë trajtimet mbrojtëse dhe është i qëndrueshëm ndaj tendosjes.
2. **Përmasat e ndryshme (127, 150 dhe 400 cm)** janë përshtatur sipas funksionit që ristela pritet të përmbushë në projektin konstruktiv ose dekorativ. Trashësia fikse 3 cm dhe gjerësia 6 cm krijojnë një profil standard për përdorim të ndarë apo të lidhur.
3. **Kualifikimi si "cilësi e parë"** nënkupton që ristela nuk duhet të përmbajë nyje të hapura, çarje të theksuara, deformime apo përmbajtje lagështie mbi normat e rekomanduara për dru të tharë teknikisht (zakonisht $\leq 18\%$).
4. **Rezistenca ndaj faktorëve të jashtëm** është kërkesë e domosdoshme për aplikimet që përfshijnë ekspozim të drejtpërdrejtë në kushte klimaterike. Kjo arrihet përmes trajtimit me **impregnantë mbrojtës, vajra, ose llakë me filtra UV**, të aplikuara në fabrikë ose në vend.
5. **Përdorimi i drurit të trajtuar për qëndrueshmëri** ndikon ndjeshëm në jetëgjatësinë dhe sigurinë strukturore të montimeve dekorative ose funksionale, si ristela në mbulesa, ndarje, mbajtëse etj.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

